

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË PROCESIN E INSPEKTIMIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektvendim ka si qëllim të përcaktojë rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative gjatë procesit të inspektimit, për shkelje të kërkesave ligjore nga subjektet e inspektimit. Projektvendimi synon të përcaktojë rregullat e përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, për mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që inspektohen, në mënyrë që dënimi administrativ të jetë përgjithësisht i njëjtë e të sigurojë trajtim të drejtë e të barabartë për subjektet e inspektimit dhe njëkohësisht të shmangë rreziqet që mund t’u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë të parashikuara me ligj.

Qëllimi i këtij projektvendimi lidhet me risinë e ligjit për inspektimin, duke parashikuar dënimin administrativ kryesor “paralajmërim”, në të gjitha rastet kur trupa e inspektimit ushtron inspektimin e parë pranë subjektit të inspektimit, përveç rasteve kur ligji i posaçëm për shkeljen ligjore të konstatuar parashikon pezullimin e aktivitetit, e cila konsiderohet shkelje e rëndë. Në vendosjen e dënitimit administrativ kryesor me paralajmërim, subjekti i inspektimit ka detyrimin të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe të eliminojë pasojat e tyre, sipas urdhërimit dhe afatit të përcaktuar nga trupa e inspektimit. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara, trupa inspektuese mund të kryejë një inspektim të ri dhe nëse konstaton se nga ana e subjektit të inspektimit nuk janë marrë masat për korrigjimin e shkeljeve, trupa inspektuese do të procedojë me vendosjen e dënitimit administrativ sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren për metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative.

Projektvendimi synon të garantojë zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosjen e masës administrative, që është dhe një nga parimet themelore të ligjit për inspektimin, me qëllim që sanksionet të jenë të përshtatshme dhe të drejta në raport me shkeljen e kryer, duke shmangur në çdo formë ndëshkimet e tepruara ndaj subjekteve të inspektimit. Sigurimi i proporcionalitetit në vendosjen e dënimeve administrative do të ndikojë në rritjen e besimit në sistemin e inspektimeve dhe në garantimin e një trajtimi të drejtë dhe të barabartë për të gjithë subjektet e inspektimit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektvendimi “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit”, është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përmbajtja e projektvendimit është hartuar në përputhje me nenin 44 “*Dënimi administrativ kryesor*” të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Në inspektimin e parë, trupa inspektuese, kur konstatojnë shkelje të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit, që përbëjnë kundërvajtje administrative, vendos dënimin administrativ kryesor “paralajmërim”, i cili shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Përrjashtim nga ky parashikim, do të përbëjnë rastet e shkeljeve ligjore, për të cilat ligji i posaçëm përcakton pezullimin e aktivitetit.

Në inspektimin për korrigjimin e shkeljeve, në rast se konstatohet se subjekti i inspektimit nuk i ka korrigjuar shkeljet e konstatuara në inspektimin e parë dhe nuk ka ndërmarrë masat për eliminimin e pasojave të tyre, trupa inspektuese merr dënimin administrativ. Gjatë procesit të inspektimit, një nga qëllimet themelore është korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe vendosja e përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi. Në rastet kur, pas lënies së një afati për përmbushjen e detyrimeve ligjore, konstatohet se subjekti i inspektimit nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për korrigjimin e shkeljeve, trupa inspektuese është detyruar të kalojë në fazën ndëshkuese të procesit. Marrja e një mase administrative ndëshkuese në këtë rast, nuk ka karakter thjesht penalizues, por shërben si mjet për të garantuar efektivitetin e ligjit dhe për të arritur qëllimin final të inspektimit, që është sigurimi i përputhshmërisë dhe mbrojtja e interesit publik. Kjo bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe synon që masa e marrë të jetë e mjaftueshme për të nxitur ndryshim të sjelljes dhe rikthimin në zbatim të rregullt të detyrimeve ligjore nga ana e subjektit të inspektimit.

Në përzgjedhjen e dënimit administrativ dhe caktimin e masës së tij, trupa inspektuese duhet të marrë parasysh përmbajtjen e faktorëve të identifikuar si:

- qëllimi, nëse shkelja është kryer me dashje ose nga pakujdesia;
- natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e veprimtarisë së subjektit;
- dëmin e shkaktuar ndaj interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, numrin e personave të tretë të dëmtuar, nëse ka, si dhe nivelin e dëmit të shkaktuar ndaj tyre; Matja e dëmit të shkaktuar ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë,

për qëllime të përzgjedhjes së dënimit administrativ dhe përcaktimit të masës së tij duhet të mbështetet në kritere të qarta dhe objektive, që ndihmojnë trupën inspektuese të veprjë në mënyrë proporcionale dhe të justifikuar. Komponentët që ndikojnë në këtë përcaktim janë të lidhur me shtrirjen e pasojave, psh: Sa i gjerë është ndikimi në interesin publik, është kombëtar apo rajonal? Lidhur me natyrën dhe intensitetin e shkeljes trupa inspektuese vlerëson nëse sa e rëndë është shkelja në raport me normën ligjore të cënuar. Psh. një shkelje që cënon sigurinë, shëndetin publik apo mjedisin ka peshë më të madhe se një shkelje formale ose procedurale.

- çdo veprim që subjekti ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e shkaktuar; shkalla e përgjegjësisë së subjektit, duke marrë parasysh masat e zbatuara prej tij për të garantuar zbatimin e ligjit; historiku i shkeljeve, veçanërisht kur ato janë të ngjashme me shkeljet në shqyrtim; bashkëpunimi me institucionin përkatës për të eliminuar apo zgjidhur problemet në kohë; zbatimi i masave për korrigjimin e shkeljeve, kur përpara shkeljes për të cilën jepet dënimi administrativ, këto masa janë dhënë ndaj subjektit në lidhje me të njëjtën shkelje ose shkelje të ngjashme; afatin e korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre; çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese që lidhet me rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja; aftësinë për të paguar të subjektit, i cili vlerëson madhësinë e subjektit të inspektimit dhe vëllimin e punës që kryen.

Dënimi administrativ kryesor “paralajmërim”, sipas ligjit për inspektimin, merret edhe kur inspektori konstaton shkelje të kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ. Në këto raste inspektoratet qendrore dhe vendore përcaktojnë në mënyrë specifike shkeljet e kërkesave ligjore me rëndësi të vogël, që mund të përbëjnë kundërvajtje administrative ose për të cilat ligji i posaçëm nuk parashikon dënim administrativ, ku subjekti dënohet me “paralajmërim”. Në këtë rast, inspektori i referohet një metodologjie të përcaktuar dhe hartuar nga inspektorati përkatës, e cila klasifikon shkeljet, ndër to edhe shkeljet e rëndësisë së vogël, pra nuk është në diskrecion të inspektorit.

Efektet e pritshme nga miratimi i këtij projektvendimi lidhen me vendosjen e një barazie dhe transparence në marrjen e vendimit përfundimtar nga inspektorët, të cilët kanë detyrimin për zbatim sipas ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Kjo synon një trajtim të njëjtë dhe të barabartë për subjektet e inspektimit, çka do të sjellë për rrjedhojë edhe përmirësimin e performancës së inspektorëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Ky projektvendim propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Rregullorja e Përgjithshme e Metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në procesin e inspektimit përbëhet nga 9 krerë, si më poshtë:

Kreu I parashikon, dispozita të përgjithshme lidhur me qëllimin, rregullat e përgjithshme bazë, përkufizime mbi termat e përdorur në rregullore si: “dënim administrativ”, “dënim administrativ kryesor”, “dënim administrativ plotësues”, “gjobë”, “faktor”, “inspektim”, “paralajmërim”, “sistemi elektronik “e-Inspektimi”, “sistem pikëzimi”, “tregues i faktorit”, kriteret për caktimin e dënimeve administrative, fushën e zbatimit të rregullores, si dhe rastet e zbatimit të saj.

Kreu II parashikon metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative, standardizimin e dënimit administrativ, duke sanksionuar edhe parashikimin ligjor mbi vendosjen e dënimit administrativ kryesor “paralajmërim” në inspektimin e parë të trupës së inspektimit.

Kreu III parashikon faktorët e riskut për përcaktimin e dënimeve administrative, ku për secilin faktor inspektoratet qendrore, vendore dhe strukturat inspektuese do të përcaktojnë treguesit dhe kufijtë minimalë dhe maksimalë të secilit prej tyre.

Kreu IV përcakton identifikimin dhe vlerësimin e faktorëve, ku në përcaktimin e faktorëve, inspektorati qendror apo vendor, sipas fushës së përgjegjësisë, vendos treguesit për secilin faktor dhe vlerësimin përkatës.

Kreu V parashikon treguesit e faktorëve që përcaktojnë masën e dënimit administrativ.

Kreu VI parashikon sistemin e pikëzimit, ku shkalla e pikëzimit do të përcaktojë vlerën e masës administrative, në intervalin e dënimit administrativ, që parashikohen në legjislacionin e posaçëm për çdo shkelje të kërkesave ligjore.

Kreu VII parashikon implementimin e metodologjisë së dënimit administrativ në sistemin elektronik të inspektimeve “e-Inspektimi”.

Kreu VIII parashikon klasifikimin e dënimeve administrative në dënime administrative kryesore, dënime administrative plotësuese, dënimin administrativ kryesor “Paralajmërim” sipas ligjit për inspektimin dhe dënimin administrativ kryesor “Për moskorrigjimin e shkeljeve”.

Kreu IX parashikon dispozita të fundit lidhur me hartimin e rregulloreve nga inspektoratet dhe strukturat inspektuese.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen ministritë e linjës, inspektoratet qendrore dhe strukturat e tjera inspektuese, Inspektorati i Përgjithshëm, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe inspektoratet vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Inspektorati Qendror (në proces ristrukturimi si Inspektorati i Përgjithshëm), në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit. Gjatë procesit të përgatitjes, projektakti është konsultuar paraprakisht me Ministrinë e Drejtësisë.

Ky bashkëpunim është zhvilluar në zbatim të *Urdhrit nr. 49, datë 26.03.2025, të Kryeministrit, "Për ngritjen e grupit drejtues ndërinstitucional të punës dhe grupeve teknike ndërinstitucionale për riorganizimin dhe ristrukturimin e inspektorateve në Republikën e Shqipërisë, për hartimin e projektakteve nënligjore në funksion të zbatimit të ligjit për inspektimin, si dhe për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit elektronik të inspektimeve 'e-Inspektimi'".*

Projektvendimi do të dërgohet për mendim në:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave;
- Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Ministrinë e Arsimit dhe Sportit;
- Ministrinë e Brendshme;
- Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit;
- Ministrinë e Financave;
- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë¹;
- Ministrinë e Drejtësisë;
- Ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor;
- Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore.

¹ Ky projektvendim nuk cenon pavarësinë institucionale të secilit inspektorat, por synon të bëjë rregullime të reja në përputhje me ligjin nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i cili shfuqizon ligjin e mëparshëm për inspektimin.

**IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
BUXHETORE**

Projektvendimi nuk shoqërohet me kosto financiare për buxhetin.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHTETIT PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

DELINA IBRAHIMAJ

